



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA FUSHE-ARREZ
KËSHILLI

Nr. 2394 Prot,

Fushë Arrëz, me 28.08.2025

P/VENDIM

Nr. 25, datë 08.08 2025

PËR

MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË MENAXHIMIT TE INTEGRUAR TË MBETJEVE
TË NGURTA URBANE PËR PERIUDHËN 2025-2030

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e IntegrUAR të Mbetjeve”, i ndryshuar me ligjin nr. 156, datë 10.10.2013, ligji nr. 9537, datë 18.05.2006, “Për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme”, ligji nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 1738, datë 12.03.2015, “Për Kriteret e Studim Projektimit për Rehabilitimin e Vendepozitimeve të mbetjeve të Ngurta Urbane, si dhe Ndërtimin e landfilleve apo Impianteve të trajtimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane”.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 27.08.2025, pasi shqyrtoi materialin e hartuar nga grupi i punës i posaçëm i ngritur për këtë qëllim dhe dëgjoi shpjegimet e specialistëve të fushës përkatëse, pas diskutimeve;

VENDOSI:

1. Të miratoi projektin e paraqitur të planit të integrUAR të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane të bashkisë Fushë-Arrëz, për periudhën 2025-2030, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe sektorët e tjerë ndëreveprues për zbatimin e tij.

PARAQITEN PROJEKTIN

DREJTORI I SHËRBIMEVE

Pashk Prëndi

KRYETARI I BASHKISË

Hil Curri

JURISTI

Redona Hasani





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA FUSHE-ARREZ
DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE



Fushe Arrez me 08/08/2025

RELACION

Mbi miratimin e planit lokal te menaxhimit te integruar te mbetjeve urbane
Bashkia Fushe Arrez per periudhen 2025-2030

Bazuar ne ligjin nr139/2015 date 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore", ligji nr 10463 date 22.09.2011 "Per Menaxhimin e Integruar te Mbetjeve" te ngurta uerbane , grupi I punes I posacem I ngritur me urdher te Kryetarit te bashkise pas nje pune te gjate hartoi :

- Draft/Planin e menaxhimit te integruar te mbetjeve per Bashkine Fushe Arrez per periudhen gusht 2025-gusht 2030.
- Per kete qellim grupi I punes si baze per hartimin e planit te integruar te mbetjeve urbane te Bashkise Fushe Arrez per periudhen gusht 2025-gusht 2030 perdori planin e vjeter te menaxhimit te integruar te mbetjeve urbane per bashkine Fushe Arrez te periudhes 2020-2025 (Plan qe I ka mbaruar afati I perdorimit)
- Ne vijim nga plani vjeter u be analize e percaktimeve te bera per tu realizuar ne 5 vjecarin e kaluar dhe rezultoi se objektivat e paracaktuara ne kete plan menaxhimi pergjithesisht nuk jane realizuar.
- Dhe realizimi I ketyre objektivave te pa realizuara se bashku me objektivat shtese ngelen sfide per tu realizuar gjate ketij 5 vjecari me planin e ri te menaxhimit te mbetjeve.
- Planin I menaxhimit te integruar te mbetjeve eshte nje document planifikimi strategjik I cili mundeson zbatimin e politikave kombetare te mbetjeve ne nivel lokal eshte nje document, udhezues I rendesisshem per menaxhimin e mbetjeve .
- Ky plan eshte I orientuar ne veprime konkrete dhe te detajuara ne lidhje me sistemin e grumbullimit ,transportit, trajtimit, riciklimit, trajtimit final dhe impakteve respective te trajtimit te mbetjeve

- Qellimi I hartimit te ketij plani konsiston ne sfiden e re qe ka bashkia per te afruar sherbimin e menaxhimit te mbetjeve ne te gjithe teritorin e saj, duke optimizuar koston e sherbimit kundrejt buxheteve te limituara qe ka bashkia si dhe ne afrimin e nevojave per investime kapitale per sektorin e menaxhimit te mbetjeve ku ne qender te vemendjes eshte percaktimi I metodologjise ,zbatimi I sistemit te monitorimit si dhe ngritja e kapaciteteve brenda bashkise .
- Ky plan menaxhimi eshe hartuar ne Përputhshmëri me Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (2020) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbetjeve.
- Ky plan menaxhimi mbeshtetet ne VKM nr. 418, datë 27.05.2020 „Dokumentine Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035“. Ky dokument strategjik do t'i mundësojë njësive të qeverisjes vendore një mjet mjaft frytdhënës për t'i udhëhequr ata në mënyrë të duhur për hartimin e planeve të tyre lokale për menaxhimin e integruar të mbeturinave, duke u bazuar në 4 qëllime strategjike për periudhën 2020-2035

Ne vijim po prezantojme ne menyre sa me koncize draft/planin local te menaxhimit te mbetjeve.

Profili i Bashkisë

Bashkia Fushë Arrëzndodhet në pjesën veri – lindore të Shqipërisëpërgjatë rrugës së kombit që lidh Shkodrën Pukën dhe Prishtinën në Kosovë. Ajo është një nga Bashkitë e Qarkut Shkodër dhe ka nën adminsitrimin e saj 5 Njësi Administrative: Fushë Arrëz, Fierzë, Blerim, Qafë-Mali dhe Iballë. Bashkia është e pozicionuar në veri-lindje të vendit në një zonë malore, me një sipërfaqe të konsiderueshme pyjore, e cila përbën edhe burimin kryesor të zhvillimit ekonomik, së bashku edhe me sektorin e minierave në veçanti atë të bakrit në kufi me Kukësin. Turizmi malor dhe bimët medicinale përbëjnë burime të tjera potenciale për zhvillimin e ardhshëm të bashkisë.

Nëntoka e bashkisë së Fushë Arrëzit është e pasur me minerale, kryesisht atë të bakrit; ndërsa pasuritë mbitokësore përfaqësohen nga të gjitha brezat bimorë, që nga shkurret mesdhetare, dushqet, pyjet (e pishës, bredhit dhe ahut), e deri tek kullotat verore në lartësi. Në të tërë zonën rriten rreth 160 lloje drurësh.

Territori i bashkisë është, gjithashtu, i pasur me burime ujore, ku rrjedha kryesore është lumi Fan i Madh. Në territiron e bashkisë është ndërtuar dy prej impianteve më të mëdha të prodhimit dhe paketimit të ujit pijshëm, “Lajthiza” dhe “Qafe Mali” te cilet tregtohen në të gjithë vendin dhe jashtë.



Të dhëna demografike


Bashkia Fushë Arrëz, është bashkia me numrin më të vogël të poullsisë në territorin e Qarkut Shkodër, ku sipas të dhënave të Regjistrit të Gjendjes civile është 10 535 banorë, me 3.868 familje në 2,264 banesa, me një densitet prej 20.1 banorë/km². Ndërkohë të dhënat e deklaruara nga CENSUS 2023 japin një numër më të vogël të popullsisë prej 7,405 banorësh me një densitet prej 13.7 banorë/km².

Bashkia Fushë Arrëz përbëhet nga 5 Njësi Administrative, ku qendra e bashkisë është ajo e qytetit të Fushë Arrëzit. Në tabelën më poshtë jepen të dhëna

demografike për bashkinë, sipas tre burimeve zyrtare, respektivisht Regjistrin e Gjendjes Civile (RGJC), INSTAT dhe Formulën e Ministrisë së Financave

Aspekte institucionale në menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Fushë Arrëz

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Fushë Arrëz ofrohet nga vetë bashkia, vetëm në dy Njësi Administrative: NJA Fushë Arrëz dhe NJA Qafë Mali




Aspekte teknike në menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Fushë Arrëz

Bashkia Fushë Arrëz e kryen vetë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve vetëm në dy NJA: Fushë Arrëz dhe Qafë Mali, ku 51.8 % të popullatës¹ ose 30% e territorit merr shërbim, siç tregohet në tabelën më poshtë:

Popullsia që merr shërbim	Popullsia sipas MFE	Përqindja e popullsisë që merr shërbim	Popullsia që merr shërbim sipas MFE	Nr. Familjeve që marrin shërbim
Fushë Arrëz	3,094	98.8%	3,057	711
Qafë Mali	1,596	87.8%	1,401	292
Blerim	1,089	0%	0	0
Iballë	1,319	0%	0	0
Fierzë	1,510	0%	0	0
Totali	8,607	51.8%	4,458	1,003

¹Popullsia sipas MFE

HARTA E MBULIMIT ME SHËRBIM SIPAS NJËSIVE ADMINISTRATIVE



Legjendë:

Kufiri i Bashkisë

Kufiri Bashkisë

Qendër Njësi Administrative

Qendër Njësi Administrative

Mbulimi me shërbim në %

0

05

08

Sistemi Rrugor

Sistemi Rrugor

Në lidhje me infrastrukturën e ofrimit të shërbimit, Bashkia Fushë Arrëz ka në pronësi 97 kontenierë 1.1m³ të shpërndarë në dy Njësitë Administrative, ku ajo aktualisht ofron shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve. Në tabelën më poshtë është bërë një përmbledhje e infrastrukturës grumbulluese të mbetjeve dhe gjendja fizike e tyre.

Njësitë me shërbim	Nr. Kontenierëve	Kontejnerë në gjendje të mirë (nr/%)	Kontejnerë në gjendje të dëmtuar (nr/%)	Kontenierë jashtë funksioni	PGM	Vite pune të kontenierëve
Fushë Arrëz	83					11
Qafë-Mali	14				7	
Gjithsej	97	13 - 14%	78 - 86%	35	80	11

Tabela 6 Gjendja teknike e kontenierëve në Bashkinë Fushë Arrëz
Burimi: [Bashkia Fushë Arrëz]

Kosto e plotë e sistemit të menaxhimit të mbeturinave

Në financat vendore në Shqipëri, në përgjithësi shpenzimet operative të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve janë planifikuar dhe realizuar vazhdimisht së bashku me shërbimet e tjera publike vendore, dhe veçanërisht të bashkuara me shpenzimet për pastrimin dhe gjelbërimin dhe shërbime të tjera publike. Në Bashkinë Fushë Arrëz është gjetur pikërisht kjo praktikë. Për rrjedhojë, buxheti i veçuar i këtij shërbimi është i përafëruar.

Në vitin 2020 (viti bazë i analizës së gjendjes aktuale), bashkia ka shpenzuar në total rreth 5,732,273 lek/vit. Nga kjo shumë rezulton se kosto vjetore e shërbimit për çdo banor të bashkisë që merr shërbim llogaritet afërsisht në 1,248 Lekë/vit ndërsa për familje në vlerën 2,820 Leke/familje/vit.

Në këtë bashki kosto e plotë e këtij shërbimi është e përbërë nga zërat më poshtë të vlerësuar në përqindje:

Sistemi i tarifave të menaxhimit të mbetjeve

Bashkia ka një databazë të pjesshme për klientët që përfshinë një pjesë të familjeve dhe kryesisht bizneset. Mungesa e një databaze të plotë për subjektet familjare është shkak kryesor për mos faturimin e tyre. Detyrimi vjetor u ngarkohet familjeve përgjithësisht nëpërmjet Zyrës së Gjendjes Civile, kur banorët paraqiten për të marrë një shërbim administrativ. Tarifa e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve u faturohet rregullisht bizneseve dhe institucioneve 1 herë në vit. Tarifa mbledhet nga bashkia nëpërmjet sporteleve pranë zyrave të bashkisë qendër ose nëpërmjet bankës; bizneset dhe institucionet derdhin tarifën kryesisht nëpërmjet bankës.

Në tabelën më poshtë jepet niveli i tarifave të miratuara nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Fushë-Arrëz:

Kategoria	Niveli i tarifave (lek/vit)
-----------	-----------------------------

Familjet	700
Familjet me ndihmë ekonomike	500
Biznesi i vogël	
Shitje me pakicë e shumicë	6,500
Prodhim	4,800
Shërbime	6,500
Ambulant	1,500
Biznes i Madh	
Lojra fati, bingo, loto	7,000
Njësi Shërbimi (Bankat, Agjensi Këmbimi Valute, Agjensi Turistike, Degët/Filialet e Kompanive Celulare dhe alb-telekom,posta shqiptare etj.)	40,000
Punime duralumini, metalesh, druri, dhe biznesi madh	60,000
Prodhime ushqimore, buke, ëmbëlsira, mishi, peshku, bulmeti	40,000
Prodhim, subjekte shërbimi dhe tregtie	50,000
Subjekte ndërtimi	50,000
Shërbime artizanale	30,000
Profesione të lira	20,000
Institucionet	
OST,QendratShëndetësore, KESH sh.a, OSHEE, Nënstacionet Elektrike	100,000
Qendra Sociale	10,000
Posta e Policisë, Ndërmarrja e Rrugëve Nacionale. Të gjitha institucionet e tjera	40,000

Tabela 9 Niveli i tarifave të pastrimit në Bashkinë Fushë-Arrëz

Burimi:[Bashkia Fushë Arrëz]

Të ardhurat e planifikuara të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Fushë Arrëz përfshijnë mbledhjen e tarifës nga institucionet dhe bizneset tek të cilët faturohet shërbim. Aktualisht nuk ka planifikim të të ardhurave nga familjet për shkak se nuk faturohet shërbimi. Për pasojë të ardhurat që mund të mbledhen gjatë vitit në rastet kur banorët paraqiten përpara bashkisë për shërbime administrative janë një shumë e rastësishme dhe shtesë ndaj planit total të të ardhurave nga bizneset dhe institucionet.

PLANIFIKIMI Lokal i menaxhimit të integruar të mbetjeve

6.1 Vizioni

Vizioni i planit lokal të menaxhimit të mbetjeve të Bashkisë Fushë Arrëz mori formë si një proces i analizimit të situatës aktuale, diskutimit dhe konsultimeve me palët e interesuara të përfshira drejtpërdrejtë në përgatitjen e planit (Grupi i Punës dhe Kryetari Bashkisë). Në fund, duke iu referuar statusit aktual të menaxhimit të mbetjeve si dhe pritshmërive për zhvillimin e këtij sektori, vlerave dhe normave qytetare, nevojës për ndryshim, u ra dakord që vizioni i bashkisë të jetë:

“Bashkia e Fushë Arrëzit një zonë me mjedis të pastër që ofron shërbime efikase për rritjen e cilësisë së jetës për qytetarët drejt një zhvillimi të qëndrueshëm”

6.2 Objektivat

Në Dokumentin e Politikave Startegjike dhe Planit Kombëtar për menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (Miratuar Maj 2020) është prezantuar një metodologji mbi bazën e prioriteteve të bashkisë për menaxhimin e mbetjeve, për të përcaktuar se cili do të konsiderohet standardi minimal, i prezantuar në ligjin e veteqeverisjet vendore (2015) për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Kjo metodologji propozon 4 hapa në shkallë, duke filluar nga më baziku deri tek ai më optimali, të cilët përcaktojnë standardin minimal të ofrimit të shërbimit:

- i. Mbulimi i 100% të territorit urban me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve
- ii. Depozitimi i mbetjeve në një vend depozitim të kontrolluar të pajisur me lejen përkatëse nga AKM-ja apo në një impiant inxhinierik
- iii. Mbulimi i 90% të territorit rural të bashkisë me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve
- iv. Ndarja në burim e mbetjeve dhe rikuperimi i energjisë

Në përcaktimin e objektivave të planit 5 vjeçar, gjatë konsultimeve me bashkinë, u ra dakord që objektivat do të përcaktohen mbi bazën e vlerësimit të performancës së shërbimit sipas indikatorëve, duke synuar hartimin e skenarëve për të përmbushur standardin minimal të ofrimit të shërbimit.

Ndarja e mbetjeve ne burim

Dokumenti i Politikave Startegjike dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (2020) ka përcaktuar disa indikatorë në lidhje me sasinë e mbetjeve që duhet të riciklohen, kompostohen sipas afateve kohore deri në vitin 2035²:

- *Mbetjet nga paketimet*
 - *Deri në vitin 2026 duhet të recuperohen jo më pak se 10% e peshës totale të mbetjeve*
 - *Deri në vitin 2026 duhet të riciklohen:*
 - *Jo më pak se 10% e peshës totale të letrës dhe kartonit*
 - *Jo më pak se 6% e peshës totale të plastikës*
 - *Jo më pak se 10% e peshës totale të qelqit*
 - *Jo më pak se 5% e peshës totale të mbetjeve nga druri*
- *Mbetjet e biodegradueshme*
 - *Deri në vitin 2026 duhet të reduktohen 80% e nivelit të vitit 2016*

Ndërkohë, sipas VKM nr. 48, datë 25.06.2017 "Për grumbullimin e ndarë të mbetjeve në burim", janë përcaktuar disa objektiva, të cilat duhet të plotësohen nga NJQV-të deri në vitin 2020, ku konkretisht:

- NJQV-të deri në fund të vitit 2018, duhet të grumbullojnë në mënyrë të diferencuar, të paktën mbetje të letrës, metalit, plastikës dhe qelqit;
- Brenda vitit 2020, ato duhet të arrijnë normën e riciklimit me 50% të sasisë të mbetjeve të vitit 2014;
- Brenda vitit 2020, sasia e mbetjeve që shkojnë në Lendfill do të jetë 45% e sasisë së mbetjeve që prodhohet, dhe pjesa tjetër duhet të shkojë për riciklim, kompostim apo për rekuperim me energji.

Pavarësisht mungesës së eksperiencës së autoriteteve lokale dhe operatorëve të mbetjeve si dhe vetë komunitetit për të ndarë mbetjet, Bashkia ka shprehur interesin e saj se fillimi i skemave të ndarjes së mbetjeve në burim, është një objektiv, të cilin ajo e vlerëson si të rëndësishëm për 5 vjeçarin e ardhshëm të zbatimit të planit.

I gjithë sistemi i ndarjes përbëhet nga dy komponentë: sistemi parësor i ndarjes dhe sistemi dytësor i ndarjes.

- **Sistemi parësor i ndarjes:** Njihet gjerësisht si ndarja në burim dhe jep rezultatin më të mirë të ndarjes. Ndarja në burim i referohet ndarjes së materialeve të riciklueshme dhe të ripërdorshme në pikën e prodhimit të tyre.
- **Sistemi dytësor i ndarjes,** nënkupton ndarjen e tyre në PGM publike të grumbullimit të tyre.

Sistemi parësor – Skema e ndarjes individuale: Sistemi i mbledhjes individuale nga familjet dhe bizneset përbën bazën për ngritjen e sistemit të ndarjes së mbetjeve. Duhet theksuar se sistemi i ndarjes në burim duket më i preferueshëm sesa sistemi i ndarjes së mbetjeve në rrugë. Nga kjo pikëpamje, angazhimi i drejtpërdrejtë i pronarëve apo personave të kontaktit të bizneseve apo familjeve siguron më shumë ndërgjegjshmëri, efektivitet dhe mundësi financimi sesa sistemi i hapur mbi të cilin mbështetet skema e përbashkët.

Ndarja në burim mund të jetë më praktike dhe e efektshme **për biznesin dhe industrinë**, ku duhet të mundësohet shërbimi individual i grumbullimit të mbetjeve. Koshat për ndarjen e mbetjeve në burim mund të vendosen në çdo njësi të madhe biznesi apo institucion shtetëror, duke ndjekur të njëjtën teknologji si sistemi i mbledhjes individuale. Sistemi duhet të jetë sa më i thjeshtë duke synuar vetëm ato mbetje apo

komponentë që mund të riciklohen. Për këtë arsye, sistemi me katër kontenierë të vegjël duket më i favorshëm se të tjerët. Kjo nënkupton caktimin e një kodi me ngjyra për alternativën me katër kontenierë që konsumatorët ta kenë parasysh, kur vendosin të depozitojnë mbetjet aty.

Objektivate që parashikojmë që do të zbatohen nga plani i ri menaxhimit të mbetjeve periudha 2025-2030.

1. Do të riparojmë dhe lyejmë me boje të gjithë kontenieret e demtuar të mbetjeve brenda vitit 2025
2. Do zhvillojmë fushata ndërgjegjësuese për ndarjen e mbetjeve në burim me komunitetin, nxenesit e shkollave si dhe shoqëri civile vazhdimisht
3. Brenda vitit 2025 në një VG të mbetjeve në qytetin Fushe Arrez sipas një projekti do bëjmë të mundur që fale ndërgjegjësimit të njerezve të bëjmë ndarjen e mbetjeve në burim. Për këtë do të sigurojmë infrastrukturen përkatëse. Ndarjen e plote të mbetjeve në burim do ta realizojmë plotësisht për qytetin Fushe Arrez brenda vitit 2028.
4. Kemi bërë një punë të lavdërueshme me menaxhimin e mbetjeve në VD e Krrabit duke i shtyrë me fadrome mbetjet përpara dhe duke i mbuluar me shtrese dheu e inerte. Këtë punë do ta vazhdojmë dhe në vijim.
5. Do t'i japim jetë VD të kthesa e Krrabit të pakten dhe për 5 vite, duke zbatuar një projekt bashkëkohor që ka të bëjë me mbylljen e këtij VD vendëpoztimi.
6. Do vazhdojmë intensivisht të llojmë prapë të gjitha instancave qeveritare që të realizohet ashtu siç është premtuar ndërtimi i një landfilli për depozitim të mbetjeve që do të shërbejë Bashkive Puke dhe Fushe Arrez dhe flitet që do të ndërtohet në Rrapë.
7. Do afrojmë në të gjithë territorin e bashkisë shërbimin e grumbullimit të mbetjeve në qendër të cdo fshati duke vazhduar nga viti 2027 e në vijim.

Faleminderit!

Harta e Vend-Depozitimit të Mbetjeve Urbane Bashkia Fushë-Arrez

4417500

4658700

4658700

Rijeti i kordinatave		
Mt. Rend	X	Y
1	417481	4656769
2	417491	4656759
3	417504	4656743
4	417508	4656735
5	417508	4656728
6	417497	4656721
7	417478	4656721
8	417465	4656723
9	417446	4656716
10	417434	4656729
11	417458	4656753



Legjenda

- Rijeti i Kordinatave
- Perimetri i pikes se grumbullimit te mbetjeve

4417500

Ushqimi i Bashkisë